



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 21.10.2015, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Shaip Muja, Srdjan Popoviq.

Munguan : Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 29.9.2015,
3. Shqyrtimi i projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit ,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.9.2015

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit

Kryesuesi Fikrim Damka përshëndeti anëtarët e komisionit dhe në cilësinë e kryesuesit të grupit punues për këtë projektligj parashitëi rekomandimet të cilat janë propozuar për komisionin si vijon :

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e Projektligjit të zëvendësohen fjalët:

“Rregull” me “Rregullore”,

“Kycje” me “Lidhje” dhe

“Shkyçje” me “Ndërprerje”.

Amendamenti 2

Neni 1, pas fjalës **shumicë**, fshihet “**në pronësi publike**” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 3

Neni 3, fshihet **paragrafi 1.7**.

Paragrafi 1.12 riformulohet si vijon:

“**Licencë e shërbimit** – leje e lëshuar nga Autoriteti me të cilën jepet autorizimi për ofrimin e shërbimit të ujit;”

Paragrafi 1.13 riformulohet si vijon:

“**Marrëveshje për pagesë** – marrëveshje e lidhur ndërmjet ofruesit të shërbimeve të ujit dhe konsumatorit për pagesë të borxhit që ka konsumatori ndaj ofruesit të shërbimeve;”

Paragrafi 1.23 riformulohet si vijon:

“**Shërbimet e ujërave të ndotura** - grumbullimi, bartja, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesit shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;”

Fshihet paragrafi 1.27

Paragrafi 1.28, riformulohet si vijon:

“**Ndërprerje** - ndërprerje e ofrimit të shërbimeve nga ofruesi i shërbimeve për shkaqe të sigurisë, operacionale, mospagesës së faturave nga ana e konsumatorit apo për shkaqe tjera të përcaktuara me këtë ligj.”

Paragrafi 1.35 riformulohet si vijon:

“**Zona e shërbimit** - rajoni ose komunat në të cilën ofruesi relevant i shërbimeve **duhet** të ofrojë shërbimet e tij në bazë të licencës së shërbimit.”

Amendamenti 4

Neni 5, në fund të **paragrafit 2**, shtohet :

“dhe të miratuar nga komisioni parlamentar përkatës”

Amendamenti 5

Neni 7, paragrafi 3.5, riformulohet si vijon :

”të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune menaxheriale.”

Amendamenti 6

Neni 14, paragrafi 3 riformulohet si vijon:

Autoriteti, pas aprovimit të buxhetit vjetor nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nxjerr Udhëzim Administrativ për lartësinë e taksës së licencimit të cilat duhet t'i sigurojnë të hyra të mjaftueshme Autoritetit për realizimin e buxhetit të aprovuar.

Amendamenti 7

Neni 16, paragrafi 3 riformulohet si vijon:

Autoriteti shqyrton aplikacionin për lëshimin ose përtëritjen e licencës për shërbime brenda afatit prej katërdhjetë e pesë (45) ditëve të punës pas marrjes së aplikacionit. Vendimi lidhur me aplikacionin nxirret pas këtij afati me kusht që të gjitha informatat dhe dokumentet e kërkuara për të marrë vendimin i janë sjellë nga ofruesi i shërbimeve.

Amendamenti 8

Neni 17, paragrafi 2.3 riformulohet si vijon:

pranon përgjegjësin për ofrim të shërbimeve në tërë zonën e shërbimit të ofruesit e shërbimit, të përcaktuara me politikat dhe planet e Qeverisë për konsolidimin e ofruesve të shërbimeve,”

Amendamenti 9

Neni 18, Paragrafi 1, në fillim pas fjalës “Autoriteti” shtohet “ në harmoni me ligjin” dhe vazhdon teksti.

Amendamenti 10

Neni 20, paragrafi 3.5 dhe paragrafi 4 fshihen.

Amendamenti 11

Titulli i kapitullit të IV, riformulohet si vijon:

“ STANDARDET E SHËRBIMIT”

Neni 21, paragrafi 2.1.5 riformulohet si vijon:

“afatin për zgjidhjen e ankesave dhe për trajtimin e kërkesave për lidhje në sistemin e ujësjellësit dhe shërbimet e ujit”

Amendamenti 12

Neni 26, pas paragrafit 2 shtohet një paragraf i ri:

Anëtarë të një Komisioni Këshillues të Konsumatorëve janë përfaqësuesit e komunave të cilat janë në kuadër të asaj zone të shërbimit dhe ata emërohen nga Autoriteti në bazë të propozimit të komunave përkatëse.”

Amendamenti 13

Neni 28,

- në paragrafin 3.7, “datën e pagesës” zëvendësohet me “në afatin e paraparë”.

- në paragrafin 3.8., “në mënyrë të pandershme” zëvendësohet me “në kundërshtim me Kartën e Konsumatorit”

Amendamenti 14

Pas nenit 47 shtohet neni i ri, si vijon:

Pronësia e aseteve të Ofruesve të Shërbimit të Ujit

1. Të gjitha asetet e sistemeve të cilat shërbejnë për ofrimin e Shërbimeve të Ujit të cilat menaxhohen nga një Ofrues i licencuar i Shërbimeve të Ujit të cilat janë në pronësi publike por që nuk janë të regjistruara në regjistrin e aseteve të atij Ofruesi të Shërbimeve duhet të regjistrohen si asete në pronësi të atij Ofruesi të Shërbimeve.

2. Për pronat tokësore në të cilat janë ndërtuar objektet e sistemeve të shërbimeve të ujit apo pronat tokësore të cilat janë përcaktuar si zona e parë e mbrojtjes së një burimi i cili shfrytëzohet për shërbimet e ujit e të cilat nuk janë në pronësi të Ofruesit të Shërbimeve të Ujit që menaxhon ato sisteme në bazë të licencës së lëshuar nga Autoriteti, duhet që Ofruesi i Shërbimeve të iniciojë procedurën e shpronësimit në pajtim me ligjin.

Komisioni votoi amendamentet një nga një të cilat u miratuan dhe u përcjellën më tutje në shqyrtim komisioneve të përhershme.

4. Të ndryshme

Kryesuesi Fikrim Damka sugjeroi për këtë pikë të formohet grupi punues për projektligjin e Obiliqit ndërsa për grupet ekzistuese punuese të riformohen për shkak të mungesës së opozitës në punën e komisionit si dhe disa çështje tjera si vijon :

1. Grupi punues për Obiliqin caktohet i njëjti grup punues i cili është i caktuar për ndotjen e mjedisit nga gjigantët mjedisor me kryesuesin **Shaip Muja**.
2. Grupi punues për Inspektoratin bujqësor riformohet me kryesuesin **Adem Salihaj** dhe anëtarët Murat Hoxha dhe Emilija Redzeqi.
3. Rreth kërkesës së kryesueses së departamentit ligjor dhe licenca në ZRRUK për dhënien e autorizimit njërit nga anëtarët e komisionit për përmbylljen e procesit të licencimit të kompanive, në mungesë të udhëheqësve të kësaj zyreje, Komisioni autorizoi Kryetarin e Komisionit të drejtohet Sekretarit të Kuvendit rreth shqyrtimit të mundësisë së urgjencës së emërimit të dy zyrtarëve në këtë zyre nga ana e Qeverisë, përndryshe do të pasoi bllokada në çështjen jetike për licencimin e kompanive që kryejnë shërbimet e ujit. Për këtë çështje **Shaip Muja** dhe **Murat Hoxha** propozuan që ish drejtori të vazhdoi punën si ushtrues detyre ngase nuk ka pengesa ligjore, deri në procedimin e drejtorit që do të propozohet nga Qeveria, ndërsa **Fikrim Damka** dhe **Adem Salihaj** ishin të mendimit që Ligji në fuqi nuk lejon këtë, ndaj si zgjedhje e përkohshme shihet një marrëveshje gojore për vazhdimin e licencimeve ose të drejtohet komisioni përkatësisht kryetari i komisionit tek sekretari i kuvendit për zgjidhje të mundshme përmes Qeverisë e cila duhet shumë shpejt ti emëroi këta dy zyrtar, përndryshe do të pasoi bllokadë jo e dëshiruar i shërbimeve ujore.
4. Kërkesa e cila është dërguar në Komision nga Agjencia e komplekseve memoriale rreth mbështetjes financiare për hartimin e strategjisë së kësaj agjencie, nga komisioni nuk arriti të finalizohet një qëndrimi definitiv ngase çështjet financiare duhet të shqyrtohen në Komisionin e Buxhetit të Kuvendit si dhe një shkresë tjetër, më heret e dërguar, për lokal me qera për shkak se zyrtarve të kësaj agjencie ju është dërguar njoftimi që duhet të lëshojnë zyret ku janë.

Mbledhja përfundoi në orën 14,00.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka